# KONTRATË

Numri i kontratës [1]: **615-21-367-1-3-6/C493**

**KOMUNA E PODUJEVËS**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

**" Sankos " Sh.p.k., rr."Vëllezerit Çaka"pn, Kaçanik**, (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

**Furnizim me veshëmbathje për inspektor** me numër identifikues: **615-21-367-1-3-6**

**Nr.brendshem-615-21-015-136**

**Neni 1**

**Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim me veshëmbathje për inspektor** nga Furnizuesi**" Sankos " Sh.p.k., rr."Vëllezerit Çaka"pn, Kaçanik**, me nr.Biznesit 811288134

Kontrata hynë në fuqi prej ditës së nënshkrimit dhe përfundon për 21 ditë punë nga data e nënshkrimit të Kontratës

| | **Furnizim me veshëmbathje për inspektor** |
|---|---|
| **Nr** | **615-21-367-136** |
| **Nr.i brendshem I prokurimit** | **615-21-015-136** |

**Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **4 355,00 €**; [katërmijetreqindepesëdhjeteepesë Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

**Neni 4-Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të mallrave

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

[1] Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.



XH. N

**Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

**Neni 7 Garancioni**
**7.1 Garancioni i egzekutimit te kontrates është 436.00€ i vlefshem deri 13/06/2021**

7.2 OE do te ofroj Garancion në shumë prej 10% të vleres se kontratës i cili do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

**Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

**Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

**Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

**Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

**Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

**Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**



XH. n

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën kompetente në pajtim me ligjin e Kosovës.

**Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen *Shqip*[2] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

jo kontratë është e përgatitur në gjuhën [3] në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | **Rasim Fejza** |
| **Pozita:** | Zyrtar përgjegjës i prokurimit |
| **Nënshkrimi:** | [signature] |
| **Data:** | 14/04/2021 |
| **Vula:** | [stamp: Republika e Kosovës, Komuna e Podujevës, Podujevë] |

**Për Furnizuesin**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | XHAVIT NEBIRAJ |
| **Pozita:** | MENAXHER |
| **Nënshkrimi:** | [signature] |
| **Data:** | 14.04.2021 |
| **Vula:** | [stamp: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar SANKOS COMPANY Kaçanik] |

SPECIFIKACION

| Nr | Emertimi | Madhësia e Rrobave | Sasia | Çmimi për Njesi € | Gjithsej € |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Komplete Seter dhe pantolla për meshkuj elegante –clasike<br>Përbërja e rrobave 80% Cotton 20%Polister<br>Ngjyra Teget | 54 | 5 | 70,00 | 350,00 |
| 2 | Komplete Seter dhe pantolla për meshkuj elegante –clasike<br>Përbërja e rrobave 80% Cotton 20%Polister<br>Ngjyra Teget | 52 | 5 | 70,00 | 350,00 |
| 3 | Komplete Seter dhe pantolla për meshkuj elegante –clasike<br>Përbërja e rrobave 80% Cotton 20%Polister<br>Ngjyra Teget | 50 | 1 | 70,00 | 70,00 |
| 4 | Komplete Seter dhe pantolla për meshkuj elegante –clasike<br>Përbërja e rrobave 80% Cotton 20%Polister<br>Ngjyra Teget | 56 | 2 | 70,00 | 140,00 |
| 5 | Komplete Seter dhe pantollona për femra elegante –clasike<br>Përbërja e rrobave 80% Cotton 20%Polister<br>Ngjyra Teget | 46 | 2 | 70,00 | 140,00 |
| 6 | Komplete Seter dhe pantollona për femra elegante –clasike<br>Përbërja e rrobave 80% Cotton 20%Polister<br>Ngjyra Teget | 44 | 1 | 70,00 | 70,00 |
| 7 | Komplete Seter dhe pantollona për femra elegante –clasike<br>Përbërja e rrobave 80% Cotton 20%Polister<br>Ngjyra Teget | 42 | 1 | 70,00 | 70,00 |
| 8 | Pallto Të gjata ( Mantilla ) për Meshkuj Clasike<br>Përbërja 80% Cotton 20%Polister,të gjata deri ne gjunje me pulla , xhepat anash<br>Ngjyra Teget apo e Zezë | 54 | 5 | 100,00 | 500,00 |
| 9 | Pallto Të gjata ( Mantilla ) për Meshkuj Clasike<br>Përbërja 80% Cotton 20%Polister, të gjata deri ne gjunje me pulla xhepat anash<br>Ngjyra Teget apo e Zezë | 52 | 5 | 100,00 | 500,00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 10 | Pallto të gjata ( Mantilla ) për Meshkuj Clasike<br>Përbërja 80% Cotton 20%Polister, të gjata deri ne gjunje me pulla , xhepat anash<br>Ngjyra Teget apo e Zezë | 50 | 1 | 100,00 | 100,00 |
| 11 | Pallto të gjata ( Mantilla ) për Meshkuj Clasike<br>Përbërja 80% Cotton 20%Polister, të gjata deri ne gjunje me pulla , xhepat anash<br>Ngjyra Teget apo e Zezë | 56 | 2 | 100,00 | 200,00 |
| 12 | Pallto të gjata ( Mantilla ) për Femra Clasike<br>Përbërja 80%Cotton 20%Polister, të gjata deri ne gjunje me pullat ,xhepat anash<br>Ngjyra Teget apo e Zezë | 46 | 1 | 100,00 | 100,00 |
| 13 | Pallto të gjata ( Mantilla ) për Femra Clasike<br>Përbërja 80%Cotton 20%Polister, të gjata deri ne gjunje me pulla, xhepat anash<br>Ngjyra Teget apo e Zezë | 44 | 2 | 100,00 | 200,00 |
| 14 | Pallto të gjata ( Mantilla ) për Femra Clasike ,<br>Përbërja 80% Cotton 20%Polister, të gjata deri ne gjunje me pulla, xhepat anash<br>Ngjyra Teget apo e Zezë | 42 | 1 | 100,00 | 100,00 |
| 15 | Këmisha për meshkuj<br>Përbërja: 100 cotton (jaka e këmishes me plastik mrapa )<br>Ngjyra: bardhë dhe kaltërt e qelët | 42 | 20 | 15,00 | 300,00 |
| 16 | Këmisha për meshkuj<br>Përbërja: 100 cotton (jaka e këmishes me plastik mrapa )<br>Ngjyra: bardhë dhe kaltërt e qelët | 43 | 2 | 15,00 | 30,00 |
| 17 | Këmisha për meshkuj<br>Përbërja: 100 cotton (jaka e këmishes me plastik mrapa )<br>Ngjyra: bardhë dhe kaltërt e qelët | 44 | 4 | 15,00 | 60,00 |
| 18 | Këmisha për femra classike-elegante<br>Përbërja: 100% cotton<br>Ngjyra: bardhe dhe kaltërt e qelët | 46 | 4 | 15,00 | 60,00 |
| 19 | Këmisha për femra classike-elegante<br>Përbërja: 100% cotton<br>Ngjyra: bardhe dhe kaltërt e qelët | 42 | 2 | 15,00 | 30,00 |
| 20 | Këmisha për femra classike-elegante<br>Përbërja: 100% cotton<br>Ngjyra: bardhe dhe kaltërt e qelët | 40 | 2 | 15,00 | 30,00 |
| | Këpuca për Meshkuj | | | 50,00 | 350,00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 21 | Përbërja e këpucave 100%lëkur ngjyra e Zezë me lidhsa elegante clasike | 42 | 7 | | |
| 22 | Këpuca për Meshkuj Përbërja e këpucave 100%lëkur ngjyra e Zezë me lidhsa elegante clasike | 43 | 1 | 50,00 | 50,00 |
| 23 | Këpuca për Meshkuj Përbërja e këpucave 100%lëkur ngjyra e Zezë me lidhsa elegante clasike | 44 | 2 | 50,00 | 100,00 |
| 24 | Këpuca për Meshkuj Përbërja e këpucave 100%lëkur ngjyra e Zezë me lidhsa elegante clasike | 41 | 1 | 50,00 | 50,00 |
| 25 | Këpuca për Meshkuj Përbërja e këpucave 100%lëkur ngjyra e Zezë me lidhsa elegante clasike | 40 | 1 | 50,00 | 50,00 |
| 26 | Këpuca për Meshkuj Përbërja e këpucave 100%lëkur ngjyra e Zezë me lidhsa elegante clasike | 45 | 1 | 50,00 | 50,00 |
| 27 | Këpuca për Femra Përbërja e këpucave 100%lëkur ngjyra e zezë pa lidhsa elegante clasike me take | 40 | 2 | 50,00 | 100,00 |
| 28 | Këpuca për Femra Përbërja e këpucave 100%lëkur ngjyra e zezë pa lidhsa elegante clasike me take | 39 | 1 | 50,00 | 50,00 |
| 29 | Këpuca për Femra Përbërja e këpucave 100%lëkur ngjyra e zezë pa lidhsa elegante clasike me take | 38 | 1 | 50,00 | 50,00 |
| 30 | Kravat për Meshkuj | | 13 | 5,00 | 65,00 |
| 31 | Shalla për femra | | 4 | 10,00 | 40,00 |
| | **Gjithsej** | | | | **4.355,00** |